

Doracak

Per Qiramarrës dhe Qiramarrësë
Qe kanë prejardhje migracioni



albanisch

Te nderuar zonja dhe zoteri

Per Qiramarrsit ne Gjermani ka rregulla dhe sjellje te veqanta te cilave duhet tu permbahet qdonjeri. Ne kete doracak do te gjeni udhezime dhe sqarime te cilat ju ndihmojne qe te keni nje pasqyre me te kjarte per kete qeshtje.

Nese ju duhet ndihme dhe mbeshtetje per kete teme, do te ju ndihmoje veshtrimi i faqes se fundit te Doracakut i cili ju udhazon se ku mund te drejtoheni per ndihme dhe udhezime.

1. Dorezimprotokolin dhe Kontraten e banimit

Kontrata e banimit dhe dorezimprotokoli jane dokumente te rendesishme sepse aty jane te rregulluara te gjitha te drejtat dhe obligimet tuaja ne kuader te marrveshjes per banim. Ne protokolin e dorezimit perpos gjendjes e baneses jane te shenuara edhe gjendja e numrit per rryme elektrike dhe nxemjes qendrore.

Kjo eshte shume e rendesishme persh. per me von kur vjene logaria per shpenzimet shtese ne banese. Protokolin e dorezimit e merrni me rastin e marrjes se Baneses nga Qiradhenesi. Prandaj ruajeni kete me kujdes ashtu si edhe kontraten e baneses ne menyre qe ne cdo kohe te keni mundesi qe ti vereni te drejtat dhe detyrimet e juaja.

Prandaj verifikojeni me kujdes vertetesin e protokoldorezimit dhe ruajeni ate ne menyre qe ne qdo kohe te keni mundesi per ti verifikuar te drejtat dhe detyrimet ndaj kontrates suaj. Nese banesa e juaj eshte e lidhur me ndonje kaucion ose aksione tjera bashkpunuese ateher pagesa e kaucionit ose vlerave tjera bashdkpunuese eshte kusht per lidhje te kontrates per qera.

Ne rast se se jeni shfrytzezues te ndihmes sociale ese ndihmave nga Enti per punesim ateher mundeni ne zyren perkatese (Enti Social ose Enti i punesimit) te beni nje kerkese per pagesen e kaucionit ose aksioneve tjera bashkpunuese per pagesen e ketyre detyrimeve.

Miratimi i kesaj kerkese mundet te behet vetem ne forme te huazimit qe domethene se kjo hua duhet te ju kthehet Enteve qe e kann dhene kete huazim.



2. Regjistrimi i Vendbanimit dhe ndryshimi i Adreses

Kujdesohuni qe cdo shperngulje apo ndrim banese ju nenshtrohet ligjit, qe ju detyron qe kete shperngulje ta lajmeroni ne zyren perkatese. Me kete sigurohet se me ju mundet te vendoset lidhja dhe te gjitha dokumentet e nevojshme munden me u derguar ne banesen e re.

Nese ndodh qe mbrenda 2 javeve nuk lajmeroheni ne Zyren e Regjistrimit, ateher duhet te llogaritni ne denime me para ne baze te ligjit federal te regjistrimit nga paragrafi § 19.

Nga Qiradhenesi i juaj e merrni nje vertetim per te drejten e banimit te cilen pastaj ja jepni Zyres se Regjistrimit. Ju mund ta beni nje termin ne Zyren e Regjistrimit permes **www.magdeburg.de**

2.1. Regjistrimi i Institucionet Zyrtare

Ju duhet qe ti lajmeroni me shkrim te gjitha Institucionet Zyrtare qe jane pergjegjese per juve per adresen e re. Ketu numrohen:

- Zyra per regjistrimin e banorve Zyra Qytetare (per ndryshimin e Adresses ne Letern-joftimin tuaj apo ne lejen e vozitjes dhe te makines)
- Enti Social- dhe Enti i Banimit
- Enti i te Rinjeve
- Qendra e Punesimit dhe
- Enti i Financimit

2.2. Regjistrimi i ri ne institucionet tjera

Adresen e re duhet me cdo kusht ta lajmeroni edhe te gjitha te tjereve me te cilet keni kontakt ne baze te punes ose kontaktet shoqerore. Kjo vlen sidomos per:

- Institutin Bankar (Sparkasse, Postbankes, Volksbank etj.).
Nese afer baneses suaj gjindet nje Bank tjeter egziston mundesia qe te beni nje kerkese per shperngulje te Kontos ne kete Filjale. Kete gje mund ta beni edhe ne
- Qerdhen e femijeve apo Shkolla
- Punedhenesi
- Avokati
- Organizatat, Ndermarrjet apo Institucionet te te cilat keni nje detyrim pagesor.
Shoqatat e keshtu me radh.
- Ndermarrjet e Sigurimit si persh. Sigurimi shendetsor, sigurimi i detyruar apo sigurimi i automjeteve e keshtu me radhe.

2.3. Regjistrimi i ri tek kontratat ne fuqi

Nese ne banese keni kontrata te pavarura te telefonit ose internetit duhet patjeter qe te jua tregoni adresen e re te banimit.

2.4.Porositja e dergimit per mes Postes

Ju mundeni qe ne cdo Poste ose online te beni nje porosi te ketill. Kjo gje ka perparesi sepse te gjitha derguesit qe nuk e din adresen e re dhe dergesat i bejne ne adresen e meparshme, Posta e bene dergimin ne adresen tuaj te re.

Mjerisht kjo porosi qe behet ne Posta nuk eshte falas. Keshtu qe shpenzimet per nje periudhe 6 mujore per porosi te tilla kushtojne 19,90 Euro, kurse per 12 muaj e nejeta kushton 26,90 Euro.

Kete mund ta beni online **www.nachsenden.info**

3. Regjistrimi

3.1.Ofruesit e Rrymes Elektrike

Ju lutemi qe te regjistroheni tek ofruesi i juaj i Rrymes. Per regjistrim ju nevojitet numri i ores i cili eshte i shenuar tek protokoli i dorzimit te baneses nga Qiradhenesi i juaj. Disa Qiradhenes si persh. WOBAU Magdeburg GmbH e marrin mbi vete kete hap te regjistrimit per ju.

3.2.ARD ZDF Radio Gjermane Sherbimi i Kontributit

Nese keni nje Radio, Televizor ose Ordinator me hyrje ne Internet ose Hendi, ateher ate duhet ta regjistroni ne nje Ent te tille qe perndryshe njihet me shkurtesen GEZ ku duhet te paguani tatim per kete. Nese merrni te ardhura nga Enti Social ose i Pune ateher ju nuk paguani tatime por duhet qe patjeter te regjistroheni te Sherbimi i Kontributit. Kerkesat per kete mund ti merrni edhe ne Entin per Regjistrim dhe ne Zyren Qytetare. Lirimi nga ky detyrim e merrni se bashku me vendimin per ndihma nga Enti per punesim apo Enti Social dhe Banimor.

Informata me te hollesishme i merrni ne: **www.rundfunkbeitrag.de**

3.3 Interneti dhe Televizioni

Per nje Lidhje te Internetit dhe Televizionit duhet te beni nje Kontrate te veqant me ofruesit e ketyre sherbimeve te cilat ju nenshtrohen pagesave te detyrueshme. Nese beni kontrate ateher ajo eshte e lidhur me nje cmim te caktuar te cilin duhet ta paguani vet. Nese deshironi qe nje keso kontrate ta perfundoni ateher duhet te ju permbaheni afateve kohore per perfundimin e kontratave te ketilla.

3.4. Sigurimi i gjerave shtepiake / sigurimi i detyrueshem

Sigurimi i baneses eshte shume i rendesishem i cili mundeson mbrojtjen e ineventarit dhe gjesendeve te baneses. Keshtu ekziston nje sigurim per mbrojtjen nga demet ne rastet e zjarrit ose demtimeve te gypave te ujit apo fatkeqesive, nga vjedhja apo thyerjes se baneses nga vandalizmi dhe stuhit e tjera.

Ne rast se keni nje demtim te ketille dhe nuk keni sigurim per kete ateher shpenzimet duhet ti bartni vet. Nje sigurim i detyrueshem privat eshte poashtu i domosdoshem. Keshtu permes ketij sigurimi rreziqet qe mund te ndodhin ne jeten e perditshme i mbulojne demet e shkaktuara.


Eshte per tu veneruar se ai qe e bene demin eshte i obliguar te paguaj qmimin e plote per te.

Me rendesi!

Nese e beni nje kontrate te till mendoni afatet kohore te sigurimit si dhe afatet per clajmrim apo perfundimin e tyre.

4. Problemet me banese

Ne rast te paraqitjes se problemeve si persh. mangesive apo demtimeve ne banese ose ne koridor, drejttohuni tek Qiradhenesi ne mynre miqesore dhe kerkoni ndihme dhe mbeshetje. Te dhenat kontaktuese te Qiradhenesit i gjeni ne dokumentet e kontrates mbi qeran. Gjat problemeve te veqanta si pershembull thyerja e gupave te ujit ateher duhet te thirrret Sherbimi Urgjent i baneses per tu lajmeruar. Per raste te tilla ne hymje te baneses suaj jan te varura dhe te paraqitur numrat e telefonit per keso raste.



5. Ndryshimet strukturore te banesave rregullimi dhe rindryshimet ne banese

Nese deshironi qe te ndryshoni dicka ne banesen tuaj (si pershembull shtruarja e laminatit apo pllakave) ateher para se ta beni kete duhet me marr leje nga qiradhenesi. Aty gjeni edhe udhezimet mbi kualitetin e punes dhe asaj se cfar duhet te keni kujdes. Perpos kesaj mund te mirreni vesh se cfar menyra dhe masa mund te dakordohen ne menyre qe kur te shpernguleni te rregullohet sic ka qene me pare apo te mbetet ashtu.

6. Shperngulja

Nese herdokurdo deshironi te shpernguleni afati kohor i qlajmrimimit eshte 3 muaj me pare. Mos harroni dhe keni kujdes ne afatet e qlajmrimimit te baneses, telefonit-, per linje kablove dhe ofrues te internetit. Keto i gjeni ne Kontraten e baneses si dhe kontratat per telefon per internet dhe linjat kablove.

Nese jeni shfrytezues te ndihmave sociale apo te ndihmave nga Enti i Punes apo Enti per Banim ateher duhet qe ketije Enti ti tregoni oferten e re te banimit. Kjo sherben per te verifikuar pershtatshmerin e madhesis se baneses si dhe cmimit. Nese e beni kete atehere ofrohet mundesia qe ky Ent te barte shpenzimet per shpengulje dhe mobilim te pare te baneses se re.

Nese posedoni nje DULDUNG ose Aufenthaltsgestattung ateher duhet patjeter qe se pari ta paraqisni nje kerkese per shperngulje tek Enti i te Huajve Entit per Punesim apo Entit Social dhe pastaj te prisni per leje ne lidhje me kete. Pergjigjet do te dergohen me shkrim.

Kujdes:

Nese beni nie kontrat banimi pa pelqimin e enteve te mesiperme mund te ju refuzohet mundesi per mbartjen e ketyre shpenzimeve per shperngulje nga zyre e permendura

7. Rregulli Shtepiak

Ju lutem kujdesuni per rendin shtepiak. Ne Gjermani duhet te ju permbahemi rregullave te caktuara qe kane te bejne me jeten e perbashket ne mes juve dhe fqinjët e juaj prandaj keto rregulla duhet te respektohen.

Se bashku me kontraten e baneses e merrni edhe nje shtojce per Rregullat shtepiake qe duhet te ju permbahemi.

a) Evitoni zhurmen



- Televizori dhe Radio te rregullohet ne pershtatshmeri me nevojat e dhomave te banimit.



- Nuk ka pune apo veprime me zhurm te larte ne banese (persh. Aspiratori, Cekici ose muzika) gjate kohes se qetesise ditore prej 13.00 deri ne ora 15.00 dhe prej ores 22.00 deri ne oren 7.00.
- Gjate te dielave dhe ditet e festave mos beni pune qe bene zhurme te madhe.
- Gjate festimeve dhe takimeve me shume musafir te cilat zgjasin me gjate se ora 22.00, duhet qe patjeter ti pyesni dhe informoni banuesit e tjere te shtepise.

b) Mbajeni rregullin dhe pastertine:

Secili banues duhet te kujdesohet qe koridori shtepiak, bodrumi tavani apo kulmi i shtepise, garazhet si dhe vendet e parkimit te mbahen te pasterta. Ne shume shtepi te banimit pastertine e kryejn Firma te veqanta dhe te gjitha shpenzimet e krijuara dergohen permes Defteses se shpenzimit te funksionimit te baneses qe ju ndahen te gjithe banuesve te shtepise. Nese ne banesen tuaj kete pergjegjesi e mbajne te gjithe banoret e asaj ndertese ateher qeradhenesi bene nja plan te pastertise te cilit duhet te ju permbahen te gjith banuesit e nderteses. Ne Gjermani Reciklimi i mbeturinave luan nje rol shume te madh. Ai e ruan ambientin dhe zvoglon shpenzimet per heqjen e mbeturinave.

Mbeturinat duhet te zbrazen plotesisht nga Kontenjeret e berllogut. Per kete duhet te kujdesemi per klasifikimin e mbeturinave:



- **Kontenjeri i zi** per tepricen e berllogut
- **Kontenjeri i verdh** per gjera plastike dhe te paketuara
- **Kontenjeri braun** per gjera te vjetruara jesore
- **Kontenjeri i kaltert** per karton dhe leter

Kapakun e kontenjerit gjithmon ta mbyllni ne menyre qe ta evitoni ndotjen e ajrit.

Evitoni stermbushjen e gypave te qarkullimit te ujit dhe Toaleteve!



Kujdes:

Mbeturinat e ushqimit, te tekstiljeve dhe artikujt e pastertise nuk i duhet ti zbrazeni ne Toalete.

Largimi i Mbeturinave dhe gjesendeve te panevojshme (Spermüll):

Per largimin e gjerve te panevojshme dhe mobiljeve te prishura nevojitet te behet nje kerkese e veqant ne Entin qe perkujdeset per mbeturinat dhe gjesendet e prishura ne Magdeburg.

Per banesen e juaj keni te drejt qe 2 her ne vite deri ne 2m kub Ose 1 her ne vite deri ne 4 m kub keto gjera pa kurrfar pagese te lejoni qe te transportohen ne vendin e duhur. Prej lajmerimit tuaj e deri tek data e transportimit te keture gjerve planifikoni me nje kohe prej 4 javesh.

Mobiljet guxoni qe vetem ne daten e transportimit ti vendosni afer rruges para shtepis ku banoni .

Kerkesat i gjeni nen: www.magdeburg.de/Leben-in-Magdeburg/Umwelt/Abfall

c) Kujdeseni per sigurine:



- Mos vendosni gjera ne shkallet e shtepise ne menyrr qe dyert emergjente dhe te shpetimit te mbahen te lira. Perndryshe rrezikoni ne raste urgjente (persh. Zjarri) jeten e juajt sie dhe jeten e banoreve te tjere te nderteses.



- Dyert shtepiAKE te hymjes ti mbyllni gjithmon ne oret e mbremjes ne menyrr qe te evitohen hyrjet e panevojshme dhe te paautorizuara.



- Per te evituar rrezikun nga zjarri duhet te ndaloni fergimin apo grillin ne oborr dhe ballkon.




- Pirja e duhanit eshte poashtu e ndaluar ne hapsirat e perbashketa te banuesve sie persh. Ne shkall te shtepise, ne dhomat perdhese dhe ne hapsirat e kulmit.

d) Radio dhe Antenat e televizionit:

Nese deshirono qe ti kapni emisionet e vendit nga vini, ju duhet nje lidhje satelitore per kete qellim duhet te beni nje kerkese me shkrim tek qiradhenesi. Pajtimi i qeradhenesit eshte e lidhur me kerkesat e tijrr per mynyren e vendosjes se ketyre lidhjeve satelitore.

e) Mbajtja e shtazeve:

Shtazet shtepiAKE mund te mbahen ne banese vetem me lejen e qiradhenesit.



8. Cmimet energjise elektrike

Me shpenzime te energjise duhet te jeni shume kursimtar, sepse keshtu kurseni parat tuaja dhe ambientin. Per shpenzimin e rrymes, ujit dhe nxemjes duhet te pershtateni nevojave tuaja per te cilat gjera vet jeni pergjegjes.

a) Nxemja dhe ajrosja



- Ajrosni shume her ne dite! Per kete duhet qe dritaret ti hapni plotesisht dhe nxemjen gjat ajrosjes ta vendosni ne moduln e mbrojtjes nga ngrirja pra ne 0.
- Nxemja e cdo dhome duhet te ngrohet njesoj. Edhe neper dhoma ku nuk shfrytezohet aq shpesh temperatura ditore nuk guxon te jet nen 16 Grad Celsius. Vetem nepermes te shperndarje te bara bart te nxemjes neper dhoma mundet te kursehete energjia.

b) Uji

- Larja me dushe kursen uje shume me teper sesa kad.
- Gjate larjes se dhembeve ose rruarjes mos e leni ujin leshuar ter kohen.
- Makina e larjes se eneve nen ujin rrjedhes shkakton shume me teper shpenzime. Mbusheni legenin me uje dhe lani enet ne ate uje. Evitoni shkrirjen dhe ftohjen e gjerave me uje nga qeshmja.

c) Rryma

- Dritat ti ndizni vetem ne dhomat ne te cilat rrini.
- Rekomandohen te perdorni lampa kursyese elektrike.
- Aparatet si persh. Televizioni, Radio, Kompjuteri, dhe HiFi-, ...) Kur ti ndalni ato, ta beni nderprerjen e plote dhe mos i leni asnjeher ne gjendje Standby). Perdorimi i kablove me nderprerje automatike apo me telekomand jane shume te pershtatshme per kete qellim.
- Ka shume metoda per te vertetuar se sa energji ju duhet. Nese shpenzoni me shume energji se sa keni kalkular ateher pagesen shtese duhet te beni vet. Nese shpenzoni rryme me teper sesa qe eshte llogaritur me pare ateher jeni te detyruar te beni vete pagesat shtese edhe nese merrni ndihma prej Entit Social ose Qendres se Punes.

Sqarimi i perkufizimeve apo terminologjise

Cmimi i shpenzimeve te perdorura (Betriebskostenabrechnung)

Drejtimi i kostove jane shpenzime te perhershme (persh. Uji, Nxemja, Pastrimi i Objektit dhe Rrugës, Sigurimi i Nderteses, Tatimet etj) Te cilet i bien pronarit te shtepise ose Parceles. Kjo eshte e rregulluar ne Kontraten e qeras qe qeramarresi (banuesi) keto shpenzime ti bart vet si pjese e qeras mujore. Pas nje viti pastaj llogaritet se ne qfar lartesisie i ka shpenzuar qiragjiu keto burime. Ky rezultat do te detajohet ne drejtimin e kostove te banimit (Betriebskostenabrechnung). Nese qeragjiu ka shpenzuar me shume se s aka paguar ateher ai duhet vet te beje pagesen shtese. Nese Ai ka shpenzuar me pak ateher atij do ti kthehen parat mbrapa.

Sigurimet (Versicherungen)

I siguruari paguan rregullisht nje shume te caktuar parash ne sigurimet. Permes kesaj Sigurimi garanton te drejten per rregullimin ne rastin e demeve. Pershembull-Sigurimi i detyruar privat, sigurimi i shtepis etj.

Pjesa Bashkepunuese (Genossenschaftsanteil)

Pjesa bashkepunuese eshte nje form e veqant e ndermarrjes. Per te gene antare i nje Shoqerie duhet qe pjesa bashkepunuese te fitohet mvarsisht nga madhesia e baneses jan shume pjese bashkepunuese per tu fituar.

Kaution (Kaution)

Kaucioni perdoret sie sigurim i qeras, ku qeradhenesi mund ta perdore nese qeradhenesi nuk i kryen obligimet pagesore. Kaucione duhet te paguhet para dorezimit te qelsave.

Kontrata e banimit (Mietvertrag)

Ne Gjermani kontrata e banimit eshte nje borgj i dyanshem juridik per lejimin e perdorimit te caktuar kohor permes se ciles nje Parti shperblehet (qeradhenesi detyrohet qe pales tjeter ti ja mundesoj banimin nese marrveshja e pageses se akorduar dyanshem qendron.

Protokoli i dorezimit (Übergabeprotokoll)

Protokol dorezimi ka te beje me nje protokol te dorezimit te baneses ne forme te shkruar ku pershkruhet gjendja e baneses para se te hyje qerammarresi dhe poashtu ne rast te shpernguljes se tije. Kjo forme sherben qe demet e shkaktuara nga qirammarresi apo dhenesi qe te ju permbahen mangesive perkatesisht demtimeve gjate kohes se banimit. Perdorimi i ketije protokoli mundeson evitimin e dallimeve ose diferencave rreth gjendjes se objektit te banimit gjate dorezimit te objektit per banim.

Meterleximi apo gjendja numerike e ores se energjis elektrike (Zählerstand)

Per te perpiluar shpenzimet e rrymes, ujit dhe nxemjes perdoren keto mjete te cilat e lexojne gjendjen e enregjis por edhe sasin e shpenzimeve te tyre. Ato jane te vendosura zakonisht ne bodrume apo kate perdhes ose (per ujin ne banjo).

Konfirmimdhënja e baneses (Wohnungsgeberbestätigung)


Konfirmimdhënja e baneses është një dokument i domosdoshëm për zyren e regjistrimit i cili i dorëzohet qeramarresit nga qeradhenesi menjëher pas nënshkrimit të kontratës për banesë.

ARD ZDF Radio Gjermania (ARD, ZDF Deutschlandradio)

Ajo është një transmetues publiko ligjor i cili nga çdo familje kërkon një shumë të caktuar të hollash.

Afati i qlajmrrimit (Kündigungsfrist)

Si afat qlajmrimi caktohet afati kohor në mëse qlajmrrimit dhe mbarimit faktik të marrdhenjes së kontratës.



2. Botimi/Shtator 2018 © Te gjitha drejtat e rezervuara

Dieses Projekt wird gefördert vom Ministerium für Inneres und Sport Sachsen-Anhalt.

per botuesit:

Landeshauptstadt Magdeburg | Sozial- und Wohnungsamt | Abt. Zuwanderung
 Caritasverband für das Bistum Magdeburg e.V. | Interkulturelles Beratungs- und Begegnungszentrum
 Wohnungsbaugesellschaft Magdeburg mbH
 Wohnungsbaugenossenschaft Magdeburg-Stadtfeld eG
 Wohnungsbaugenossenschaft Otto von Guericke eG
 MWG-Wohnungsgenossenschaft eG Magdeburg

E drejta e Autorit dhe drejtat ndihmese

Publikimi i përmbajtjeve si dhe informatave të ofruara iu nënshtrohen të drejtës së autorit dhe ligjit për mbrojtjen e performancës. Çdo lloj shprehjeje së përdorimit si dhe çdo lloj zgjerimi apo shpërndarjeje, incizimi apo përfaqësimi jashtë kufijve të botuesve kërkohet për qimë me shkrim nga ana e drejtës së autoreve. Kopjimi i palejuar i informacioneve të ofruara është e ndaluar dhe dënueshem.

Ku mund te ndihmohem? / Adresat e rendesishme

Keshillimi dhe informatat

Shoqata e Caritasit per Ipushkevi te Magdeburgut
Interkulturelles Beratungs- und Begegnungszentrum
Karl-Schmidt-Str. 5c
39104 Magdeburg
Tel.: 0391 408 05 14 oder 0391 408 05 15

Qendra e Konsumatorve Magdeburg

Breiter Weg 32
39104 Magdeburg
Tel.: 0391 543 9979

Shoqata e Qiragjinjeve Magdeburg

Otto-v.-Guericke-Str. 6
39104 Magdeburg
Tel.: 0391 561 91 55 oder 0391 541 01 09
E-Mail: info@mvmd.de

Zyra e Qytetare te Qytetit te Magdeburgut:

Zyra Qytetare e Qendres: Leiterstr. 2A
Zyra Qytetare Lindore: Tessenowstr. 15
Zyra Qytetare Jugore: Salbker Chaussee 67
Zyra Qytetare Perendimre: Bruno-Beye-Ring 50
Zyra Qytetare Veriore: Lübecker Str. 32

Keshillimoret per Borgjelinje te Qerave ose borgjeve te Energjise:

Enti Social dhe i Banesave Magdeburg
Wilhelm-Höpfner-Ring 4
39116 Magdeburg
Tel. 0391 540 34 08

Shoqata Gjermane e Mirqenjes se Perbashket

Wienerstr. 2
39108 Magdeburg
Tel.: 0391 629 33 73

Unioni Nderkombetar Magdeburg

Walther-Rathenau-Str. 30
39104 Magdeburg
Tel.: 0391 739 10 89

Organizata e Mirqenjes se Punes Magdeburg.

Thiemstr. 12
39104 Magdeburg
Tel.: 0391 406 80 31

Kerkesat per marrjen e shpenzumeve te shpernguljeve dhe shpenzimeve te qerave

Cendra e Punes e Kryeqytetit te Landit ne Magdeburg
Otto-v.-Guericke-Str. 12a
39104 Magdeburg

Enti Sociale i Banesave Magdeburg

Wilhelm-Höpfner-Ring 4
39116 Magdeburg
Tel.: 0391 540 34 08

Sherbimi Shtepiak dhe Mobiljar

AQB gGmbH
Morgenstr. 10
39124 Magdeburg
Tel.: 0391 72 72 60

GISE

Schönebecker Str. 56
39104 Magdeburg
Tel.: 0391 40 95 1 07

Banesat

WOBAU – Bursa e Banesave
Breiter Weg 117a
39104 Magdeburg
Tel.: 0391 610 44 44

Koperacioni Banesor Otto von Guericke eG

Scharnhorstring 8/9
39130 Magdeburg
Tel.: 0391 726 12 00

Koperacioni Banesor Magdeburg-Stadtfeld eG

Peter-Paul-Str. 32
39106 Magdeburg
Tel.: 0391 568 49 10

MWG-Koperacioni Banesor Magdeburg

Letzlinger Str. 5
39106 Magdeburg
Tel.: 0391 569 84 44

Me teper informata gjeni ne faqen onlein te udhezimeve per migrantet nen:

www.willkommen-in-magdeburg.de